KOMUNIKATË PËR WEB

Çështjet e komuniteteve minoritare në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave

20.11.2023

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) u mbajt takim me Këshilltaren e Kryeministrit (KM) për Minoritete, znj. Elizabeth Gowing dhe këshilltarin e Kryeministrit për komunitetin Ashkali, z. Artan Asllani.

Takimin e udhëhoqi U.d. Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së, z. Avni Kastrati, i cili i potencoi sfidat me angazhimin e OJQ-ve që është anuluar për shkak të datës së Regjistrimit, që do të mbahet vitin e ardhshëm, për që gjë do të shikohet legjislacioni në fuqi.

Pastaj, në takim u diskutua edhe çështja e përkthimin e Pyetësorëve dhe Fletëpalosjes në gjuhën turke dhe rome, si dhe angazhimi i komuniteteve minoritare në Regjistrim.

Znj. Gowing njoftoi se në ZKM ka divizion të veçantë për përkthimin në gjuhën rome, derisa në gjuhën turke përkthimet janë kryer nga Ambasada Turke në Kosovë.

Në takim u ngrit për diskutim edhe çështja e regjistrimit të përkatësisë etnike, gjuhës dhe religjionit. Z. Kastrati i njoftoi këshilltarët e KM-së se këto tri pyetje nuk janë të obligueshme dhe se mund të shikohen nga të anketuarit (respondentët) për t'u përgjigjur ose jo. Po ashtu, u sqarua se ASK është duke punuar edhe për QR kodin e këtyre pyetjeve, ku pas një muaji secili të ketë mundësi ta shohë deklarimin e tij përmes numrit personal.

Ndërkaq, për sa i përket Konkursit për regjistrues dhe mbikëqyrës dhe ri-zgjatjen e tij deri më 31 dhjetor 2023 u kërkua që të vendoset linku edhe në Buletinin e Komuniteteve.